

NEW APOLLONIA SHPK  
RRUGA "PAPA GJON PALI II", NR. 12, KATI 11, ZYRA 1100, KUTIA POSTARE 1010, NJËSIA BASHKIAKE NR. 2, TIRANË  
NIPT M41929022N

---

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 14/11/2024 në orën 10.30, në selinë e Shoqërisë New Apollonia SHPK, regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi M41929022N, me adresë në Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 12, kati 11, Zyra 1100, Kutia Postare 1010, Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, Shqipëri, (në vijim referuar si "**Shoqëria**"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, me të pranishëm:

- **Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT K72223031K dhe seli në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", Ndërtesa nr. 12, kati 11, Zyra nr. 1100, Tiranë, përfaqësuar nga administratori i saj Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare lindur në Tiranë më 03.02.1983, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal I35203147R, - ortak i Shoqërisë dhe zotërues i 100% (*njëqind përqind*) të kuotave të kapitalit themeltar të saj ("**Ortak i Vetëm**");

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Rozana Kodrari, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. **Zmadhimin e kapitalit të shoqërisë New Apollonia**

Duke kaluar në diskutimin e çështjes në Rend të Ditës, Kryetari parashtrohet se për nevoja operacionale të Shoqërisë kërkohet financimi i saj me një shumë prej 98,000,000 lekë. Financimi do të jepet në formën e kontributit në para në kapitalin e Shoqërisë dhe do të shlyhet tërësisht nga Ortaku i Vetëm. Pas zmadhimit, kapitali i Shoqërisë nga 50.000 (*pesëdhjetë mijë*) LEK, do të bëhet 98.050.000 LEK.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

VENDOSI:

- a) Të miratojë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë New Apollonia SHPK (NUIS: M41929022N) me 98.000.000 (*nëntëdhjetë e tetë milion*) LEK.
- b) Zmadhimi i kapitalit do të nënshkruhet dhe shlyhet tërësisht nga Ortaku i Vetëm në para. Kapitali i Shoqërisë nga 50.000 (*pesëdhjetë mijë*) LEK pas zmadhimit të bëhet 98.050.000 LEK.

- c) Të autorizojë Administratorin në detyrë të Shoqërisë për zbatimin e këtij vendimit dhe të kryejë të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

\* \* \* \* \*

Meqenëse nuk pati çështje të tjera për t'u shqyrtuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Ky Vendim i Shoqërisë, i mbajtur në formën e procesverbalit, nënshkruhet rregullisht në përputhje me parashikimet e nenit 90/3 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nga Sekretari dhe Kryetari i Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.

\*\*\*\*\*

ASAMBLEJA E PËRGJITHSME E SHOQËRISË  
NEW APOLLONIA SHPK

KRYETAR

  
ZNJ. EDLIRA MUKA

SEKRETAR

  
ZNJ. DEA FILIPI

